



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 30.10.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.10.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Proing@Partners" për aktivitetin: < "Inçizimet gjeodezike për zonat Çagllavicë dhe Hajvali" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-103-221 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Proing@Partners" e datës 26.10.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Inçizimet gjeodezike për zonat Çagllavicë dhe Hajvali" me Nr.616 18 103 221 kundër *Njoftimit për dhënje të kontratës* të AK –së, të datës 22.10.2018, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Vërtetohet *Njoftimi për dhënje të kontratës* i publikuar me datë: 22.10.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin*.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Proing@Partners" me datë 22.10.2018 ka parashtruar kërkesën-ankesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Inçizimet gjeodezike për zonat Çagllavicë dhe Hajvali", me numër të prokurimit 616 18 103 221.

Autoriteti Kontraktues, me datë 30.10.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

1. Pretendimi i parashtruesit të kërkesës se i tenderuesi i propozuar për dhënje të kontratës nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat financiare nga dosja e tenderit është i pa bazuar, pasi që nga dëshmitë e dorëzuara vërtetohet se grupi i OE-ik të propozuar për

dhënje të kontratës ka qarkullim për periudhën e kërkuar për shërbie të ngjajshme mbi 100,000.00 euro;

-Poashtu pretendimi për licencën për një nga softverët është i pa qëndrueshëm për faktin se kërkesa jonë ka qenë të dëshmohet posedimi i një licence lidhur me këtë dhe nuk është kërkuar asnjë dëshmi e pagesës apo dëshmi tjetër;

-Dhe pretendimi tjetër poshtu është plotësisht i pabazuar, pasi që sipas të njejtit Formulari i tenderit duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e grupit (pika 33.8 e RRUOPP-se), por kjo është e rregulluar me piken 33.18 ku thuhet se Nënshkrimi elektronik i avancuar dhe koha e vulosjes së ofertave nga serveri nuk është i obligueshëm deri në njoftimin zyrtar nga KRPP-ja.

Bazuar në të gjitha sqarimet paraprake u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit